



Që ne shqiptarët jemi gjaknxehtë dhe i interpretojmë gjërat sipas interesave kjo dihet, por s'më kishte shkuar në mendje se do të arrinim deri aty sa t'i binim në qafë një djaloshi 20 vjeçar vetëm e vetëm se ai i është mirënjohës shtetit dhe komunitetit ku jeton për ç'ka ka arritur në futboll. Se besoja se ne shqiptarët, në mbarë shqiptarinë, do ofendoheshim vetëm e vetëm se djaloshi që u largua vetëm 2 vjeç nga vendi, nuk njih historinë e UÇK-së. Fundja, në shkollat greke nuk bëhet historia shqiptare dhe anasjelltas. Se besoja se respektin ndaj tjetrit do ia merrnin për dobësi, ose më saktë për tradhëti. Sërisht s'më besohet se do të keqinterpretonim fjalët dhe ndjesën që ai kërkoi. S'më besohet, se sot, në vitin 2013 ne, të jemi kaq mendje mbyllur dhe t'i themi tjetrit «ti ke respektuar tjetrin, ne ofendohemi dhe ti nuk e meriton fanelën e kombëtares». Kështu thamë edhe për kapitenin pas dy humbjeve ë fundit, «t'i hiqet shiriti». Si mund të veprohet kështu, si mund të keqpërdoren mediat dhe të njolloset një lojtar që me kaq ngulm e sollëm në kombëtare?! Mos harrojmë që të dyja kombëtares respektive e kërkuan por, ai ndoqi zemrën dhe u bashkua me kuqezinjët. Derisa ai do të kontribuojë për ne, për të arritur ëndrën që ne besojmë pse i biem «në qafë» për gjëra dytësore? Se besoja që ne nuk po i dalim në krah për ta mbështetur tani në këto momente të vështira. Si i quajmë Xhakën, Shaqirin, Behramin, Xhemailin, Kabashin etj etj..?! Pse të mos ndihemi krenarë që, këta djem që kanë të njëjtin gjak si ne, luajnë me ekipet më prestigjioze europiane, duke na bërë krenarë që kanë prejardhjen dhe rrënjë nga po i njëjti vend si ne. E mbani mend precedentin Mavraj? Si e quajtëm? Tani e duartrokasim. Mos ndoshta këtu «tradhëtia» u kthye në respekt?! Se besoj se tani po më quani dhe mua «grek», vetëm e vetëm se kam pikëpamje ndryshe nga ju?!

Të respektojmë, të nderojmë, të duam por mbi të gjitha të mos harrojmë historinë dhe gjakun e derdhur nga UÇK-ja, për çlirimin e Kosovës. Le të mos e kthejmë këtë patriotizëm në nacionalizëm të shëmtuar, për të dëmtuar veten dhe tjetrin. Fundja le të mos biem në nivelin dhe në mendësinë e tyre.

Arnold DHIMITRI